REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Nr. 4088 Prot. Tiranë, më 21.08.2026

UDHËZIM

Nr. 618, datë 21.08.2026

PËR

PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË PËR SHTETASIT ≥ 35 VJEÇ

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit Nr. 185, datë 02.04.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës mbi 35 vjeç", të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 845, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë aksionare 'Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore' sh.a. (OSHISH sh.a.)", të ndryshuar,

UDHËZON:

A. OBJEKTI

1. Ky udhëzim përcakton procedurat për organizimin, ofrimin, kryerjen, dokumentimin, referimin dhe ndjekjen e kontrollit mjekësor bazë për shtetasit ≥ 35 vjeç, pa kufi të sipërm moshor.
2. Përfituesi ka të drejtë ta kryejë kontrollin mjekësor bazë pa pagesë, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.
3. Kontrolli mjekësor bazë ofrohet në mënyrë periodike, sipas përcaktimeve të programit dhe protokolleve të miratuara.
4. Pas përfundimit të kontratës së partneritetit publik-privat, organizimi, administrimi dhe ofrimi i shërbimeve të Programit kombëtar të kontrollit mjekësor bazë kryhet nga Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore sh.a. (OSHISH sh.a.), shoqëri anonime me kapital 100% shtetëror me aksioner të vetëm Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
5. Ofrimi i Programit të kontrollit mjekësor bazë realizohet në bashkëpunim me strukturat e kujdesit shëndetësor parësor, sipas përgjegjësive të përcaktuara në këtë udhëzim.

6. Komponentët e Programit të kontrollit mjekësor bazë që realizohen në qendrat shëndetësore kryhen nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor, ndërsa administrimi i laboratorëve, proceset laboratorike, sistemi informatik, furnizimi me materiale dhe proceset logjistike të Programit janë në përgjegjësi të OSHISH sh.a., sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

B. PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE

1. "Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore sh.a", (OSHISH sh.a.),

1.1. OSHISH sh.a. është përgjegjëse për:

a) organizimin dhe administrimin operacional të Programit kombëtar të kontrollit mjekësor bazë;
b) administrimin e rrjetit të laboratorëve dhe të pikave të ofrimit të shërbimit;
c) koordinimin e proceseve logjistike dhe informatike që lidhen me realizimin e Programit;
d) sigurimin e pajisjeve, aseteve dhe materialeve të nevojshme për realizimin e Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, sipas përgjegjësive të përcaktuara në këtë udhëzim;
e) kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të nevojshme për zbatimin e programit, brenda fushës së veprimtarisë së saj.

1.2. Në zbatim të përgjegjësive të mësipërme, OSHISH sh.a. siguron furnizimin dhe rifurnizimin e qendrave shëndetësore me materialet e konsumit, pyetësorët, formularët dhe materialet e tjera të nevojshme për realizimin e Programit.

1.3. OSHISH sh.a. organizon marrjen në dorëzim dhe transportin e mostrave biologjike nga qendrat shëndetësore, analizimin e tyre në laboratorët që ka në administrim, si dhe regjistrimin e rezultateve laboratorike në sistemin informatik të Programit.

1.4. OSHISH sh.a. raporton periodikisht për:

a) numrin e përfituesve të paraqitur;
b) numrin e kontrolleve të përfunduara;
c) numrin dhe llojin e ekzaminimeve të kryera;
d) rezultatet dhe rastet e identifikuara për ndjekje;
e) treguesit e cilësisë dhe performancës së shërbimit si dhe të dhëna të agreguara.

1.5. Raportimi për treguesit e performancës kryhet çdo muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës për aktivitetin e muajit paraardhës, dhe i përcillet Drejtorisë së Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

1.6. OSHISH sh.a. vë në dispozicion të OSHKSH-së dhe strukturave të saj, sipas fushës së përgjegjësisë dhe rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, informacionin dhe treguesit e nevojshëm për ushtrimin e funksionit të monitorimit.

1.7. OSHISH sh.a. dhe strukturat e Kujdesit Shëndetësor Parësor bashkëpunojnë për sigurimin e vazhdimësisë, cilësisë dhe aksesit të pandërprerë në program.

2. Fondi i Sigurimeve të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)

2.1. FSDKSH lidh kontratën për financimin e shërbimit të kontrollit mjekësor bazë me OSHISH sh.a.. Kontrata duhet të rregullojë e të përcaktojë, në mënyrë të hollësishme, formën e dhënies së këtij shërbimi dhe mënyrën e financimit së tij.

2.2. FSDKSH monitoron zbatimin e detyrimeve financiare dhe kontraktuale lidhur me ofrimin e shërbimit.

2.3. Në kontratat që FSDKSH lidh me qendrat shëndetësore për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor, përfshihen detyrimet për organizimin, thirrjen e përfituesve, ofrimin, dokumentimin dhe raportimin e kontrollit mjekësor bazë, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi dhe të akteve të tjera në fuqi.

2.4. FSDKSH, pas përfundimit të çdo tremujori dhe brenda datës 10 të muajit pasardhës, i përcjell ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë informacion për monitorimin e detyrimeve financiare dhe kontraktuale të lidhura me Programin, problematikat e konstatuara dhe masat e marra sipas kompetencave të tij.

3. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH)

3.1. OSHKSH koordinon organizimin e procesit të njoftimit të përfituesve, si dhe monitoron zbatimin e tij nga strukturat e varësisë.

3.2. Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), në territorin e tyre të përgjegjësisë, përgjigjen për organizimin dhe koordinimin e procesit të njoftimit të qytetarëve, në bashkëpunim me OSHKSH dhe qendrat shëndetësore.

3.2.1. Monitorimi në terren nga NJVKSH-të përfshin, në veçanti: organizimin dhe funksionimin e shërbimit, procesin e njoftimit dhe pjesëmarrjes së përfituesve, respektimin e procedurave të përcaktuara, dokumentimin në sistemin informatik, ruajtjen dhe mirëpërdorimin e pajisjeve që administrohen nga QSH, disponueshmërinë dhe administrimin e materialeve të konsumit, marrjen dhe dorëzimin e mostrave biologjike, si dhe evidentimin e problematikave dhe ndjekjen e masave korrigjuese që janë në përgjegjësi të QSH-së.

3.2.2. NJVKSH-të përgatisin çdo tre muaj raportin e monitorimeve të kryera në terren dhe e përcjellin atë nëpërmjet strukturës rajonale përkatëse pranë OSHKSH-së Qendrore, për konsolidim në nivel kombëtar.

3.3. OSHKSH monitoron në mënyrë periodike njoftimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, ndërsa OSHISH sh.a. siguron mbështetjen organizative, informatike dhe logjistike të nevojshme për administrimin e procesit.

3.4. Drejtoria Qendrore OSHKSH, brenda muajit që pason përfundimin e çdo tremujori, i përcjell Drejtorisë së Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë raportin tremujor të monitorimit, duke evidentuar gjetjet kryesore, problematikat e konstatuara, masat e marra dhe çështjet që kërkojnë ndërhyrje në nivel qendror.

4. Instituti i Shëndeti Publik (ISHP)

4.1. Regjistri Kombëtar i Kontrollit Mjekësor Bazë, i krijuar mbi bazën e të dhënave të mbledhura në kuadër të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, administrohet nga Instituti i Shëndetit Publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.2. ISHP grumbullon, përpunon, analizon dhe diseminon të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë për qëllime monitorimi, vlerësimi epidemiologjik, planifikimi, kërkimi shkencor dhe zhvillimi të politikave të shëndetit publik.

4.3. OSHISH sh.a. siguron funksionimin dhe administrimin teknik të sistemit informatik të Programit, si dhe transmetimin e të dhënave pranë Regjistrit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, sipas standardeve dhe procedurave të miratuara.

4.4. Mënyra e grumbullimit, përpunimit, analizës, diseminimit dhe aksesit në të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë realizohet sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit.

4.5. ISHP harton raporte periodike mbi gjetjet kryesore të Programit, treguesit e faktorëve të riskut, tendencat epidemiologjike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave dhe programeve të shëndetit publik, dhe ia përcjell ato ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

5. Qendrat Shëndetësore (QSH)

5.1. QSH janë përgjegjëse për thirrjen dhe njoftimin individual të përfituesve të regjistruar pranë tyre dhe për organizimin e paraqitjes së tyre për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë.

5.2. Identifikimi i shtetasve që përfitojnë nga Programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë bëhet nëpërmjet sistemeve informatike shëndetësore dhe listave të banorëve të regjistruar pranë qendrave të kujdesit shëndetësor parësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.3. Thirrja e qytetarëve kryhet nëpërmjet një ose më shumë prej mënyrave të mëposhtme:

a) njoftimit telefonik;
b) mesazheve elektronike ose SMS;
c) njoftimit nëpërmjet sistemeve elektronike të shërbimeve shëndetësore;
d) njoftimit gjatë kontaktit me mjekun e familjes ose personelin shëndetësor;
e) mjeteve të tjera të komunikimit të përcaktuara nga OSHKSH.

5.4. Për shërbimin e kontrollit mjekësor bazë, çdo QSH ka për detyrë:

a) të evidentojë sipas regjistrit elektronik të të siguruarve shtetasit ≥ 35 vjeç, në territorin që mbulohet nga QSH;
b) të sigurojë mjedisin (dhomën), që do të shërbejë për kryerjen e ekzaminimeve sipas Programit kombëtar të kontrollit mjekësor bazë;
c) të përgjigjet për ruajtjen, përdorimin e rregullt të pajisjeve, aseteve dhe materialeve që ndodhen në mjedisin e dedikuar për kontrollin mjekësor bazë dhe janë në inventarin ose administrimin e saj;
d) të marrë në dorëzim, të ruajë dhe të administrojë materialet e konsumit të siguruara nga OSHISH sh.a., si dhe të njoftojë në kohë për nevojat për rifurnizim;
e) të hartojë në bashkëpunim me OSHISH sh.a. grafikun e dorëzimit të mostrave në laborator;
f) të plotësojë modulet e sistemit të informacionit, të programit të kontrollit mjekësor bazë;
g) të bëjë vlerësimin, dhe komunikimin e riskut për personat e grupmoshës 35 vjeç e sipër, që kanë kryer kontrollin mjekësor bazë.

5.5. Qendra Shëndetësore (QSH) është përgjegjëse për plotësimin, administrimin dhe raportimin në format elektronik dhe/ose të printuar të dokumentacionit të Programit kombëtar të kontrollit mjekësor bazë, përfshirë "Formularin e kontrollit mjekësor bazë" dhe "Përgjigjen përfundimtare për kontrollin mjekësor bazë".

C. PROCESI I KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË

1. Kontrolli mjekësor bazë kryhet në përputhje me përmbajtjen e paketës së shërbimit të miratuar, protokollet dhe procedurat teknike në fuqi dhe përfshin, sipas përcaktimeve të tyre, vlerësimin e faktorëve të riskut dhe të stilit të jetesës, matjen dhe vlerësimin e parametrave fiziologjikë, kryerjen e ekzaminimeve laboratorike dhe ekzaminimeve të tjera të përcaktuara, si dhe këshillimin, vlerësimin mjekësor dhe referimin sipas sistemit të referimit në fuqi dhe protokolleve klinike përkatëse.

2. Kontrolli mjekësor bazë nuk zëvendëson shërbimin mjekësor të nevojshëm për pacientët me sëmundje të diagnostikuara dhe nuk kufizon të drejtën e tyre për të kërkuar apo marrë shërbim shëndetësor.

3. Të gjitha etapat e kontrollit mjekësor bazë dokumentohen në sistemet informatike të përcaktuara. Analizimi i mostrave biologjike kryhet në laboratorët e administruar nga OSHISH sh.a. Pas përfundimit të analizimit, rezultatet laboratorike regjistrohen nga OSHISH sh.a. në sistemin informatik të Programit dhe bëhen të aksesueshme për mjekun e familjes të QSH-së për vlerësimin dhe ndjekjen e mëtejshme të përfituesit.

4. Të dhënat e programit përdoren për:

   a) dokumentimin e shërbimit të kryer;
   b) ndjekjen e përfituesve;

c) monitorimin e indikatorëve të programit;
d) planifikimin dhe menaxhimin e shërbimeve parandaluese;
e) vlerësimin e performancës së programit;
f) monitorimin epidemiologjik dhe vlerësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës;
g) planifikimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve të shëndetit publik.

5. Personeli shëndetësor zbaton protokollet dhe procedurat profesionale të miratuara për secilin komponent të kontrollit mjekësor bazë.

6. Gjatë kryerjes së kontrollit mjekësor bazë respektohen parimet e konfidencialitetit, etikës profesionale, informimit të pacientit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

7. Përfituesit njoftohen për:

   a) të drejtën për të përfituar kontrollin mjekësor bazë pa pagesë;
   b) datën, orën dhe vendin e paraqitjes;
   c) dokumentacionin ose të dhënat e nevojshme për identifikim;
   d) rëndësinë e kryerjes së kontrollit dhe ndjekjes së rekomandimeve të mjekut;
   e) Në rast të mosparaqitjes së qytetarit në datën e përcaktuar, qendra shëndetësore ndërmerr të paktën një njoftim të dytë dhe, sipas rastit, cakton një datë alternative për kryerjen e kontrollit.

Monitorimi dhe vlerësimi i programit

1. Monitorimi dhe vlerësimi i Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë kryhet në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar cilësinë, efektivitetin, aksesin dhe përdorimin e burimeve në përputhje me objektivat e Programit.

2. OSHISH sh.a. monitoron zbatimin operacional të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë dhe raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë mbi ecurinë e zbatimit, treguesit e performancës, problematikat e evidentuara dhe masat e marra për përmirësimin e shërbimit.

3. OSHKSH, nëpërmjet strukturave të saj qendrore dhe vendore, monitoron zbatimin e Programit në qendrat shëndetësore, përfshirë procesin e njoftimit të përfituesve, organizimin e shërbimit, respektimin e procedurave dhe dokumentimin e aktivitetit në sistemet përkatëse.

4. FSDKSH monitoron zbatimin e detyrimeve financiare dhe kontraktuale që lidhen me financimin e Programit dhe raporton pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë mbi rezultatet e monitorimit.

5. ISHP kryen vlerësimin epidemiologjik të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, bazuar në të dhënat e Regjistrit Kombëtar, analizon treguesit kryesorë të shëndetit të popullatës, faktorët e riskut dhe tendencat e identifikuara, si dhe harton raporte analitike dhe rekomandime për politikat dhe programet e shëndetit publik.

6. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, bazuar në raportimet dhe analizat e institucioneve të përfshira, kryen vlerësimin e përgjithshëm të Programit dhe merr masat e nevojshme për përmirësimin e organizimit, financimit dhe cilësisë së shërbimeve.
7. Institucionet e përfshira në zbatimin e Programit bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për monitorimin dhe vlerësimin e tij, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit.

Detyrat e Mjekut të Familjes

1. Në kuadër të kontrollit mjekësor bazë, mjeku i familjes:
   a) vlerëson faktorët individualë të riskut;
   b) identifikon rastet që kërkojnë ndjekje të mëtejshme;
   c) jep këshillimin përkatës për stilin e jetesës dhe parandalimin;
   d) vendos për ndjekjen, diagnostikimin ose trajtimin e mëtejshëm;
   e) referon pacientin te mjeku specialist, kur është e nevojshme.
2. Pas përfundimit të ekzaminimeve, mjeku i familjes shqyrton të dhënat e mbledhura, rezultatet laboratorike dhe rezultatet e komponentëve të tjerë të kontrollit mjekësor bazë.
3. Të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë procesit dokumentohen në sistemet e përcaktuara për Programin kombëtar të kontrollit mjekësor bazë.
4. Në rast se gjatë kontrollit mjekësor bazë evidentohen rezultate jashtë vlerave të pritshme, faktorë të rëndësishëm risku ose shenja që kërkojnë vlerësim të mëtejshëm, përfituesi referohet sipas sistemit të referimit në fuqi.
5. Referimi dokumentohet në sistemin elektronik dhe i komunikohet përfituesit.
6. Mjeku i familjes përgjigjet për ndjekjen e pacientit të identifikuar me faktorë risku ose problematika shëndetësore, në përputhje me protokollet dhe kuadrin rregullator në fuqi.

Detyrat e infermierit

1. Mbështet mjekun e familjes dhe kontribuon në njoftimin e shtetasve të grupmoshës 35 vjeç e sipër për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë.
2. Pret shtetasit e ardhur sipas njoftimit të mëparshëm në ambientin përkatës të QSH, të rezervuar për ata që do të kryejnë kontrollin mjekësor bazë.
3. Verifikon me kujdes fletë njoftimin për kontroll dhe dokumentin e identifikimit. Plotëson dhe administron të dhënat e formularit te kontrollit mjekësor bazë sipas moduleve përgjegjëse.
4. Këshillon shtetasit që kryejnë kontrollin mjekësor bazë mbështetur në algoritmet sipas moduleve përgjegjëse.

5. Kryen të gjitha matjet dhe ekzaminimet e përshkruara të kontrollit mjekësor bazë dhe i regjistron në sistemin informatik përkatës.
6. Përgjigjet për dorëzimin e formularit të kontrollit mjekësor bazë, epruvetave dhe kontenierëve tek përfaqësuesi i OSHISH sh.a. si dhe për marrjen në dorëzim të rezultateve të kontrollit mjekësor bazë.
7. Hedh brenda muajit pasardhës përgjigjen përfundimtare të MPF në sistemin informatik dhe e vendos në dosjen personale të kontrollit mjekësor bazë.

D. DISPOZITA TË FUNDIT

1. OSHISH sh.a. harton dhe miraton procedurat standarde të punës, formularët operacionalë, skemat e organizimit të shërbimit dhe mekanizmat e raportimit të nevojshëm për zbatimin e këtij udhëzimi. Procedurat hartohen në koordinim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, OSHKSH dhe FSDKSH, sipas fushës së përgjegjësisë së secilit.
2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, OSHISH sh.a., FSDKSH, OSHKSH dhe qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS SALA